



## **WUS Austria Prishtina Office Media Report 2007**

- 25.07.2007** Bota Sot - "Agjencia e Akreditimit mund të shpëtojë arsimin e lartë në Kosovë"  
Epoka e Re: "Kosova duhet të zhvillojë edhe arsimin"  
Lajm - "Universiteti, veç mësimdhënësve, duhet të ketë edhe shkenctarë"  
Zëri: "Qeveria austriake rikonfirmon mbështetjen për arsimin kosovar"  
Kosova Sot - "Austriakët themelojnë Agjencinë e Akreditimit"  
Format: "Auf Bildungs-Mission"
- 10.03.2007** Lajm: "17 studentë kosovarë ne finalen e Vjenës"
- 03.03.2007** Lajm: "72 studentë garojnë për Finalen e Vjenës"  
Zëri: "Nis gara studentore për Rastin Sfidues të Kosovës"
- 02.03.2007** Kosova Press: "Prezantohet projekti Rasti Sfidues i Kosovës 2007"
- 25.07.2007** Bota Sot - "Agjencia e Akreditimit mund të shpëtojë arsimin e lartë në Kosovë"

# AGJENCIA E AKREDITIMIT MUND TA SHPËTOJË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

**Ministri austriak premtoi programe për bursa, të cilat studentët nga Kosova mund t'i shfrytëzojnë gjatë studimeve të tyre në Kosovë dhe jasht saj.**

Prishtinë, 24 korrik

Tejkalimin e krizës së arsimit të lartë në Kosovë shpresohet ta bëjë Agjencia Kosovare e Akreditimit, e themeluar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të cilën është zotuar të martën ta financojë Qeveria e Austrisë. Së bashku me tejkalimin e krizës së vlerave, të cilën besohet ta bëjë Agjencia, problemet e tjera në infrastrukturë do të mund të zgjidhen me ndihmë në infrastrukturë nga qeveritë si ajo e Austrisë. Ministri i Shkencës dhe Hulumtimeve i Austrisë, dr. Johannes Hahn, tha se qeveria austriake do të ndihmojë aktivisht me 4.5 milionë euro sistemin arsimor në Kosovë, pas një takimi që pati me zëvendëskryeministrin Lutfi Hazirin dhe rektorin e Universitetit

me për bursa, të cilat studentët nga Kosova mund t'i shfrytëzojnë. Rektori Hasani tha se me ministrin Hahn ka biseduar për bashkëpunimin e UP-së me universitetet austriake dhe shtetin austriak, i cili ka qenë shumë solidar dhe e ka ndihmuar arsimin shqip gjatë tërë këtyre vjetëve. "Qeveria austriake ka zotuar 3 milionë euro, të cilat janë ndarë mes pjesëve të tjera të arsimit të lartë. Unë jam informuar rreth zhvillimeve të fundit të agjencisë. Na janë dhënë garanci nga ana e ministrit për ndihmën që Austria do të ofrojë për stafin tonë akademik dhe projektet hulumtuese në trajnime, bursa, dërgimin e asistenteve të rinj për shkollim të mëtejshëm", tha ai.

ku ne do të mund të ishim aktivë dhe në fakt jemi aktivë", tha ai. Ministri Hahn, në këtë kontekst tha se Kosova ka pasurinë më të madhe që është për një vend, rininë, e cila përbën 50 për qind të popullsisë. Hahn tha më tej se do të vazhdojë të ofrojë mbështetje në fushën e edukimit, pasi sipas tij është fusha më e rëndësishme që një politikan do të bënte për vendin e tij. Ai tha se me zëvendëskryeministrin Haziri ka diskutuar për themelimin e Agjencisë së Akreditimit, meqë, sipas tij, kjo është shumë me rëndësi për Kosovën. Aktualisht në tërë vendin janë të paktën 19 institucione të licencuara private të arsimit të lartë dhe gati po aq në pritje dhe të palicencuara.

**Austria është donatorja më e madhe për arsimin në Kosovës tha zëvendëskryeministri Haziri në takim me Ministrin e Shkencës dhe Hulumtimeve i Austrisë, dr. Johannes Hahn**

melimit të Agjencisë së Akreditimit. Ai i lavdëroi predispozitat e kësaj Agjencie, pasi anëtarë të saj një pjesë janë ndërkombëtarë dhe një pjesë vendorë. Por, ka kaluar më shumë se gjysmë që nga themelimi i Agjencisë, e parashikuar me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe që ajo nuk ka filluar punën normale, pasi dy anëtarë ndërkombëtarë, njëri evropian nga qeveria e Austrisë dhe një amerikan, nuk qenë emëruar deri pak javë më parë.

Agjencia e Akreditimit është institucioni përkatës që vlerëson punën e institucioneve akademike publike apo private dhe i vetmi institucion që mund të kërkojë mbylljen e cilitdo institucion përkohësisht apo përfundimisht për shkak të mospërbushjes së kriterëve të parashikuara me ligje dhe udhëzime administrative.

Ai tha se projekti që ndihmon Agjencinë është serioz dhe garanton pavarësinë e saj.

Ministri austriak premtoi progra-

duke shprehur habinë se mund të ndodhin edhe trillime të tilla, tha qetë se nuk ekziston një universitet i atillë në Austri. "Nuk është e vërtetë se është i licencuar", tha Hahn. Ai tha se ka disa universitete private në Austri, që licencohen çdo pesë vjet, por një universitet i tillë nuk është. I pyetur nëse propaganda e rrejshme e UBT-së se është licencuar nga qeveria austriake, dëmtton imazhin e asaj qeverie, ministri Hahn, tha se kjo është çështje e Qeverisë së Kosovës dhe problemin duhet zgjidhur këtu. Ministri Hahn tha se qeveria austriake që nga viti 1999 e ka ndihmuar arsimin në Kosovë me rreth 50 milionë euro. Mistri Federal pas takimit me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Lutfi Hazirin, tha se krahas zgjidhjes së statusit, Kosova duhet ta zhvillojë edhe arsimin, pasi, siç tha ai, një shteti të fort i duhet një shoqëri e arsimuar. "Ne do të dëshironim t'i harxhonim paratë në programe të ndryshme, sepse ka fusha të shumta

Kosovë dhe në UP në punën kërkimore shkencore, nuk u shpreh qartë, por veçoi rëndësinë e pjesëmarrjes së akademikëve në jetën institucionale, përkatësisht në shtet. "Natyrisht që ky është qëllimi ynë kryesor i aktiviteteve tona jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan, pra që të ngrihet struktura shkencore në shtet dhe që të arrihen kjo është një sfidë edhe për Austrinë", tha Hahn. Hasani tha se Austria do të ofrojë për stafin akademik të UP-së edhe projekte hulumtuese në trajnime, bursa, dërgimin e asistenteve të rinj për shkollim të mëtejshëm. Ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë ka zhvilluar dje një takim edhe në Word University Service - Austrian Commitee (VUS) Austria në Prishtinë. Mysafirët nga Austria janë njoftuar nga krerët e kësaj organizate për projektet e VUS-it dhe punën e tij që nga themelimi, veçanërisht kontributin në zhvillimin e kurrikulave në UP. Menaxheri i VUS-it në Prishtinë, But Dedaj, e njoftoi ministrin Hahn për punën e kësaj organizate në Prishtinë, me projektet e saj që i ka implementuar në UP, e veçmas në Fakultetin Teknik.

Idriz MORINA

BOJA SOT 25.07.07

Zëvendëskryeministri Lutfi Haziri ka takuar ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim të Austrisë, Johannes Hahn

"EPOKA ERE" 25-07-07

# Kosova duhet ta zhvillojë edhe arsimin

## Austria financon themelimin e Agjencisë për akreditimin e universiteteve

Prishtinë, 24 korrik - Ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë, Johannes Hahn, ka thënë në Prishtinë se vendi i tij do të financojë themelimin e Agjencisë për akreditimin e universiteteve kosovare për të garantuar cilësinë në arsimin e lartë në vend. Ministri Hahn, pas një takimi që pati të martën me zëvendëskryeministrin Lutfi Haziri, ka thënë se krahas zgjidhjes së statusit, Kosova duhet ta zhvillojë edhe arsimin, pasi, siç ka thënë ai, një shteti të fort i duhet një shoqëri e arsimuar. Hahn ka njoftuar se shteti austriak deri më tani në Kosovë ka shpenzuar më se 50 milionë euro në fushën e zhvillimit të edukimit, ndërsa buxheti aktiv është rreth 4.5 milionë euro. "Ne do të dëshironim t'i harxhonim paratë në programe të ndryshme, sepse ka fusha të shumta ku ne do të mundë të ishim aktiv dhe në fakt jemi aktiv", ka thënë ai, duke shtuar se Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, prandaj, siç ka thënë ai, ka burime që të ketë një zhvillim të shkëlqyer, duke marrë parasysh të rinjtë, të cilët dëshirojnë të shkollohen. Ministri austriak dhe zëvendëskryeministri kosovar kanë diskutuar për funksionalizimin e Agjencisë për akreditimin e universiteteve, pasi, siç ka thënë ai, kjo është shumë me rëndësi për Kosovën kur dihet se ka një numër të madh (mbi 20) të universiteteve private. Hahn ka thënë se duhet të garantohet kualiteti i universiteteve, posaçërisht për familjet të cilat paguajnë nëpër universitetet private. "Edhe niveli i mësimin duhet të jetë i shkëlqyer dhe



i bazuar në standardet evropiane dhe ne dëshirojmë të ofrojmë këtë nivel, dhe për këtë arsye është e domosdoshme të ketë një akreditim të tillë dhe shpresojmë që ta themelojmë gjatë ditëve të ardhshme", ka deklaruar ministri austriak Hahn. Themelimi i kësaj Agjencie, sipas tij, ka të bëjë edhe me emërimin e ekspertëve dhe është mirë që të paktën gjysma e të emëruarve të jenë ekspertë nga jashtë, në mënyrë që të garantohet pavarësia e kësaj agjencie, pasi që kjo është e shkruar edhe me ligj. "Ne jemi krenar ta mbështesim këtë vend të mrekullueshëm, i cili është

pjesë e Evropës dhe presim që edhe zyrtarisht të bëhet pjesë e saj", ka thënë në fund ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë, Johannes Hahn. Ndërsa, zëvendëskryeministri Haziri ka theksuar rëndësinë e kësaj marrëveshje, pasi edhe ai ka pranuar faktin që për të ndërtuar një shtet të fort duhet pasur një shoqëri të edukuar mirë. "Austria është donatorja më e madhe për arsimin në Kosovë dhe për këtë i jemi mirënjohës. Kosova ende ka nevojë për donatorë të huaj e sidomos në fushën e edukimit", ka thënë Haziri. Ndryshe një vit më parë Qeveria e Austrisë dhe ajo e Kosovës

kanë nënshkruar një marrëveshje për mbështetje të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vlerë prej 3 milionë euro. Kjo marrëveshje përfshin themelimin dhe vendosjen e Agjencisë së Akreditimit, mbështetjen e studentëve dhe profesorëve të UP-së dhe, sipas kësaj marrëveshje, paralelisht do të punohet edhe në mbështetje të sektorit privat. Ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë, Hahn, së bashku me një delegacion të MASHT-it, gjatë ditës ka vizituar edhe zyrën e WUS - Austria në Prishtinë dhe Universitetin e Prishtinës. (ksl)

Ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë, Johannes Hahn, premtoi mbështetje për reformat në arsimin e lartë

# Universiteti, veç mësimdhënësve, duhet të ketë edhe shkencëtarë

ANITA KADRIU

Prishtinë, 24 korrik - Qeveria austriake edhe njëherë ka konfirmuar mbështetjen e saj të plotë për reformimin e sistemit arsimor në Kosovë. Ministri i Arsimit të Austrisë, Johannes Hahn, tha të martën në Prishtinë se vendi i tij do të vazhdojë edhe më tutje me implementimin e projekteve në përmirësimin e nivelit të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe trajnimit të punonjësve

akademikë të Universitetit të Prishtinës (UP). Pas takimit me rektorin e UP-së, Enver Hasani, ministri Hahn tha në një konferencë për media se tashmë është më se e nevojshme që në Kosovë të ndërtohet edhe infrastruktura kërkimore - shkencore. "Duhet të themelohet një nivel intelektual, jo vetëm mësimor, por edhe kërkimor-shkencor, të pakën në disa fusha të rëndësishme". Qeveria austriake deri më tash ka

ndihmuar përmirësimin e jetës arsimore në Kosovë me projekte të ndryshme në vlerë prej 50 milionë eurove, ku katër milionë euro e gjysmë janë duke u shfrytëzuar aktualisht për ngritjen e sistemit arsimor kosovar. Ministri austriak tha se me rektorin Hasani ka shkëmbyer shumë ide, por është përqendruar te themelimin final i Agjencisë së Akreditimit. "Mendoj se mund ta finalizojmë shpejt këtë projekt, dhe është shumë me rëndësi që agjencia përbëhet nga ekspertë vendorë dhe të huaj. Kjo agjenci do të vlerësojë programet dhe planprogramet studimore, dhe në bazë të këtij vlerësimi do të vendoset, apo të paktën do t'i jepen rekomandime Ministrisë së Arsimit se cili universitet publik, ose privat, duhet të licencohet". Hahn tha se qeveria austriake ofron disa programe për bursa studimore të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët kosovarë. Gjatë këtij takimi është biseduar edhe për të ardhmen e universiteteve evropiane. Ministri austriak tha se reformat në arsim janë të

domosdoshme pasi parashihet që deri në vitin 2020 secili student evropian të paktën një semestër ta ndjekë në një universitet jashtë vendit të tij. Ndërsa rektori Hasani tha se me ministrin Hahn ka biseduar kryesisht për çështjet e bashkëpunimit reciprok midis Universitetit të Prishtinës dhe atyre austriake. "Shteti austriak ka qenë shumë instrumental dhe na ka ndihmuar gjatë tërë këtyre viteve. Austria do të ofrojë për stafin akademik të UP-së edhe projekte hulumtuese në trajnime, bursa si dhe dërgimin e asistentëve të rinj për shkollim të mëtejshëm". Ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë, Hahn, gjatë vizitës në Kosovë ka pasur takim edhe me përfaqësuesit e "Word University Service - Austrian Committee" (VUS) në Prishtinë. Delegacioni nga Austria i kryesuar nga Hahn është njoftuar nga udhëheqja e kësaj organizate për projektet e VUS-it dhe punën e saj, veçanërisht kontributin në zhvillimin e kurrikulave në UP.



Foto: KDRAS BASHA

. LAJMI 25. 07. 07

Ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë u takua me liderë e përfaqësues të arsimit në Kosovë

## Qeveria austriake rikonfirmon mbështetjen për arsimin kosovar

Ministri austriak Johannes Hahn tha se tash për tash edhe 4.5 milionë euro janë duke u shfrytëzuar për ngritjen e sistemit arsimor, ndërsa theksoi se me rektorin Enver Hasani ka shkëmbyer ide, duke u përqendruar më së shumti në themelimin final të Agjencisë së Akreditimit, për të cilën ai theksoi se është shumë e rëndësishme që agjencia përbëhet nga ekspertë vendorë dhe të huaj

### Besa Bytyçi

Qeveria austriake edhe një herë ka rikonfirmuar mbështetjen e saj të plotë për zhvillimin e sistemit arsimor në Kosovë, edhe pse nga viti 1999, ky vend ka ndihmuar në përmirësimin e jetës arsimore në vendin tonë me rreth 50 milionë euro. Këtë e ka deklaruar dje në Prishtinë ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë, në disa takime që ka pasur me liderë e përfaqësues të arsimit të lartë në Kosovë.

Pas një takimi që pati të martën me zëvendëskryeministrin e Kosovës Lutfi Haziri, ministri Hahn tha se krahas zgjidhjes së statusit, Kosova duhet ta zhvillojë edhe arsimin, pasi siç tha ai, një shteti të fortë i duhet një shoqëri e arsimuar.

Ministri austriak njoftoi se shteti austriak deri tani në Kosovë ka shpenzuar më se 50 milionë euro në fushën e zhvillimit të edukimit, ndërsa buxheti aktiv është rreth 4.5 milionë euro.

"Ne do të dëshironim t'i harxhoni paratë në programe të ndryshme, sepse ka fusha të shumta ku ne do të mund të ishim aktiv dhe në fakt jemi aktiv", tha ai, dhe theksoi se Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, prandaj siç tha ai, ka burime që të ketë një zhvillim të shkëlqyer duke marrë parasysh të rinjtë të cilët dëshirojnë të shkollohen.

Hahn, tha më tej se do të vazhdojë të ofrojë mbështetje në fushën e

edukimit, pasi sipas tij, është fusha më e rëndësishme që një politikan do ta bënte për vendin e tij.

Më tej njoftoi se temë diskutimi me zëvendëskryeministrin Haziri, ishte edhe themelimi i Agjencisë për Akreditimin e universiteteve, pasi siç tha ai, kjo është shumë e rëndësishme për Kosovën kur dihet se ka një numër të madh, rreth 20 universitete private.

Themelimi i kësaj agjencie, sipas tij, ka të bëjë edhe me emërimin e ekspertëve dhe sipas tij, është mirë që të paktën gjysma e të emëruarve të jenë ekspert nga jashtë në mënyrë që të garantohet pavarësia e kësaj agjencie, pasi që kjo është e shkruar edhe me Ligj.

"Kosova është në rrugë të mirë dhe mendoj se kjo është e sajuar në pjesët e statusin, nga ana tjetër duhet të shohim se zhvillimi i edukimit është po ashtu me rëndësi dhe ne duhet të punojmë në mënyrë paralele. Ne jemi krenar ta mbështesim këtë vend të mrekullueshëm i cili është pjesë e Evropës dhe presim që edhe zyrtarisht të bëhet pjesë e saj", tha ministri austriak i arsimit.

Ndërsa, zëvendëskryeministri Haziri theksoi se Austria është donatorja më e madhe për arsimin në Kosovë dhe "për këtë i jemi mirënjohës, pasi Kosova ende ka nevojë për donatorë të huaj e sidomos në fushën e edukimit".

Ndërkaq, në një takim që ministri Hahn ka pasur me rektorin Enver

Hasani, ka deklaruar se vendi i tij do të vazhdojë implementimin e projekteve në përmirësimin e nivelit të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe trajnimit të stafit akademik, konkretisht të UP-së. Ai theksoi se është më se e nevojshme që në Kosovë të ndërtohet infrastruktura kërkimore-shkencore. "Duhet të themelohet një nivel intelektual jo vetëm mësimor por edhe kërkimor të paktën në disa fusha".

Ministri austriak i Arsimit tha se tash për tash edhe 4.5 milionë euro janë duke u shfrytëzuar për ngritjen e sistemit arsimor, ndërsa theksoi se me rektorin Enver Hasani ka shkëmbyer ide, duke u përqendruar më së shumti në themelimin final të Agjencisë së Akreditimit. "Mendoj se mund ta finalizojmë këtë projekt dhe është shumë e rëndësishme që agjencia përbëhet nga njëra anë nga ekspertë vendorë dhe nga ana tjetër ekspertë të huaj", tha ai. Kjo agjenci, theksoi Hahn, do të vlerësojë programet dhe plan-programet dhe në bazë të këtij vlerësimi do të vendosë, apo të paktën do t'i japë rekomandime ministrit, se cili universitet publik ose privat duhet të licencohet.

Ai tha se qeveria austriake ofron disa programe për bursa, të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët kosovarë.

Gjatë këtij takimi është biseduar edhe për të ardhmen e universiteteve evropiane. Ministri Hahn tha se parashihet që deri në vitin 2020 secili

studentë evropianë të paktën një semestër ta ndjekë në një universitet tjetër evropian.

Ndërsa, rektori i Universitetit të Prishtinës (UP) Enver Hasani tha se me ministrin ka biseduar për çështjet e bashkëpunimit mes Universitetit të Prishtinës dhe atyre austriake. "Shteti austriak ka qenë shumë instrumental dhe na ka ndihmuar gjatë tërë këtyre viteve. Qeveria austriake ka zotuar 3 milionë, të cilat janë ndarë mes pjesëve tjera të arsimit të lartë".

Hasani tha se Austria do të ofrojë për stafin akademik të UP-së edhe projekte hulumtuese në trajnime, bursa, dërgimin e asistentëve të rinj për shkollim të mëtejshëm.

Ministri Federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë, ka zhvilluar dje një takim edhe

Word University Service - Austrian Committee (VUS) Austria në Prishtinë.

Mysafirët nga Austria janë njoftuar nga kërret e kësaj organizate për projektet e VUS-it dhe punën e saj që nga themelimi, veçanërisht kontributin në zhvillimin e kurrikulave në UP-së.

Me këtë rast, menaxheri i VUS-it në Prishtinë, But Dedaj i ka njoftuar min-

istrin Hahn me punën e kësaj organizate në Prishtinë, me projektet e saj që i ka implementuar në UP, e veçmas në Fakultetin Teknik. Dedaj e ka njoftuar ministrin Han edhe me sistemin e reformave që ka filluar të implementohet që nga vitin 2001 sipas Deklaratës së Bolonjës. Ai më këtë rast ka thënë se Austria është i pari shtet, i cili e ka ndihmuar arsimin kosovar që nga vitin 1998. ■



**FIBULA**  
AIR Travel Agency

Qershor (Marte&Premta) Fluturime direkte për Antalya 15.06.2007

**Antalya 389.00 €**  
\*pa Taksa

**Greqi 59.00 €**

Stamboll tre herë në javë: Marta, Enjte, Diele

**Stamboll 59.00 €**  
\*pa Taksa

The art of traveling...

Dy Herë në javë  
Shkup-Sarajevë

Tel: +381 38 24 25 26  
Fax: +381 38 24 59 82  
info@fibula-ks.com  
www.fibula-ks.com

Zëri 25.07.07

# Austriakët themelojnë Agjencinë e Akreditimit

**M**inistri federal për Shkencë dhe Hulumtim i Austrisë, z. Johannes Hahn, me një delegacion nga Austria me rastin e vizitës së Kosovë ka pasur takim me rektorin Enver Hasani, si dhe me udhëheqësit e VUS Austrisë në Prishtinë. "Me ministrin kemi biseduar për çështjet e bashkëpunimit mes UP-së, universiteteve austriake, dhe shtetit austriak, i cili ka qenë shumë instrumental dhe na ka ndihmuar gjatë tërë këtyre viteve. Qeveria austriake ka zotuar 3 mil-

ionë euro, të cilat janë ndarë mes pjesëve tjera të arsimit të lartë", tha Rektori Hasani. Ai shtoi se janë informuar rreth zhvillimeve të fundit të agjencisë. "Neve na janë dhënë garanci nga ana e ministrit për ndihmën që Austria do të ofrojë për stafin tonë akademik dhe projektet hulumtuese në trajnime, bursa, dërgimin e asistentëve të rinj për shkollim të mëtejshëm". Ndërkaq, ministri austriak, Johannes Hahn, pohoi se në takimin e sotëm është biseduar për shumë çështje, pika më

e rëndësishme ishte themelimi final i Agjencisë së Akreditimit dhe mendoj se mund ta finalizojmë, sepse është shumë me rëndësi që agjencia përbëhet nga njëra anë nga ekspertë vendorë dhe nga ana tjetër ekspertë të huaj. Sipas tij, ky është një projekt ku garantohej pavarësia e agjencisë, sepse është shumë me rëndësi që kjo agjenci të vlerësojë programet dhe planprogramet dhe në bazë të këtij vlerësimi agjencia do të vendosë, apo të paktën do të japë rekomandime ministrit se cili universitet, publik ose privat, duhet të licencohet dhe kjo ka të bëjë me nivelin e mësimdhënies dhe politikën arsimore në Kosovë. Ministri Johannes Hahn ka pasur takim edhe me përfaqësuesit e 'World University Service - Austrian Committee - VUS - Austria' në Prishtinë. Mysafirët nga Austria janë njoftuar për projektet e VUS-it dhe

punën e saj që nga themelimi. Me këtë rast menaxheri i VUS Austria në Prishtinë, Bud Dedaj i ka njoftuar ministrin Hahn me punën e VUS-it në Prishtinë, me projektet që i ka implementuar në UP e veçmas në Fakultetin Teknik. Dedaj i ka njoftuar ministrin Hahn edhe me sistemin e reformave që ka filluar të implementohet që nga vitin 2001 sipas Deklaratës së Bolonjës. Ai me këtë rast ka thënë se Austria është i pari shtet i cili e ka ndihmuar arsimin kosovar që nga vitin 1998. Përmes projekteve të VUS Austria studentët e UP-së janë njohur me shumë gjëra të rëndësishme në fushën e arsimit. Në anën tjetër, profesorët nga Austria, të cilët ishin prezentë në këtë takim, janë interesuar edhe për numrin e studentëve që studiojnë në UP, si dhe në cilat fakultete ka numër më të madh të studentëve. V. R.

## PROGRAMI I VUS-it

Jahja Drançolli, profesor në Fakultetin Filozofik - Dega e Historisë, tha: "Ne në Kosovë 10 vjet nuk kemi pasur kontakte me Evropën, Austria është i pari shtet që na e ka hapur dritarën për të komunikuar me Evropën. Ndihmësa e VUS-it sidomos në shkencat shoqërore është e rëndësishme, pasi që ne kemi pasur begründ komunist dhe socialist". Sipas tij, me projektet e VUS-it dhe programet e reja studentët tanë më lehtë i janë qasur shkencës dhe janë njohur edhe me literaturë të huaj.

"KOSOVA SOT" 25.07.07

# Auf Bildungs- Mission

Wissenschaftsminister Johannes Hahn reist auf den Balkan, um dort Neues über europäische Hochschulpolitik, Studienbedingungen und Aufnahmetests zu lernen.



Ich spreche nicht von Problemen, sondern von Herausforderungen.“ Immer wieder hört man diesen Stehsatz von Politikern und er heißt sinngemäß: „Natürlich gibt es Probleme, aber gehen wir die Sache trotzdem mal positiv an.“ Auch Johannes Hahn sagt diesen Satz gerne, er ist von ihm des öfteren zu hören. Noch ist es zu früh zu bewerten, ob der Wissenschaftsminister auf das, was er Herausforderungen nennt, Lösungen parat hat oder ob er nur einen eingeübten Satz mantraartig wiederholt.

Als Hahn aber am vergangenen Dienstag bei seinem Besuch in Pristina, der Hauptstadt der serbischen Provinz Kosovo, ebenfalls von Herausforderungen anstatt von Problemen in der örtlichen Universitätslandschaft sprach, klang das angesichts der Trostlosigkeit der politischen Situation im Kosovo eigentlich fast politisch naiv. Was Hahn aber definitiv nicht ist. Viel eher ließ der Ausspruch etwas aufblitzen, was Hahns politische

Stärke auszumachen scheint: Beharrlichkeit. Obwohl der promovierter Philosoph manchmal zurückhaltend, fast schon schüchtern wirkt, steckt in Hahn, der bereits mit 22 Jahren den Kampf gegen den Krebs aufnahm und ihn nach vielen Jahren gewann, Entschlossenheit und Wille.

Ein echter Visionär ist hingegen Hahn keiner. Er orientiert sich in der universitären Landschaft an Begriffen aus der Wirtschaft: „Benchmarks“ und „Wissensstandards“, die Leistungsbeurteilung voraussetzen, Zwangsmaßnahmen nicht ausschließen und dem humanistischen Zugang eines Humboldt'schen Bildungskonzepts gegenüberstehen. Der Sozialdemokratie wirft Hahn vor, „eine Philosophie des Additiven“ zu haben: „Sie versuchen immer, zum Bestehenden etwas dazuzugeben.“ Hahns Philosophie dagegen besteht darin, Grenzen anzuerkennen und er meint damit die Notwendigkeit von

Studiengebühren ebenso wie „Prüfungen“ beim Übergang von Volksschule und AHS (siehe dazu auch S. 15) und beharrt auf seiner Forderung einer verpflichtenden Vorschule für Kinder mit Sprachschwierigkeiten. Eltern, die sich weigern, sollte die Familienbeihilfe gestrichen werden. „Eine bessere Integration der Kinder von Einwanderern beginnt beim Spracherwerb“, sagt Hahn und verweist im selben Atemzug darauf, dass die Identifikation mit Institutionen steigt, „wenn man dafür im Vorfeld etwas leisten“ muss. Hahn: „Wir haben bei den ÖH-Wahlen gesehen,

dass die Wahlbeteiligung bei jenen Unis gestiegen ist, wo es Aufnahmebeschränkungen gibt.“ Die Medizin- und Veterinär-Unis also. Bei den großen

Universitäten wie der Uni Wien sinke die Wahlbeteiligung weiter.

Auch ein anderer Gedanke des Ministers zielt darauf ab, Aufnahmeprüfungen als Instrument zur Steuerung der sozialen Ausgewogenheit von Studierenden stärker einzusetzen. Wie die am Mittwoch in Wien präsentierte Studie des Ministeriums zeigt, schaffen deutlich mehr Studenten den Sprung an die Fachhochschule aus bildungsfernen Schichten (junge Menschen, deren Vater über keinen akademischen Abschluss verfügt, Anm) als an den Universitäten. Auch das ist für Hahn ein Argument, intensiver als bisher über Aufnahmeprüfungen nachzudenken.

Was Hahn auch häufig wiederholt, ist der Satz von der Bedeutung der Bildung für die Demokratie, Wohlstand und Frieden in einer Gesellschaft und überall, wo er hinkommt, schlägt ihm bei diesem Satz heftiges Kopfnicken entgegen. Auch bei seinen Gesprächspartnern am Balkan, die



MINISTER-PLAUSCH. Hahn besucht die Uni Pristina (links). Im Gespräch mit dem Vize-Premier des Kosovo, Lutfi Haziri.



**ÖVP-  
WISSENSCHAFTS-  
MINISTER  
HAHN. „Eine  
bessere Inte-  
gration der  
Kinder von  
Einwanderern  
beginnt beim  
Spracher-  
werb.“**

Hahn am Montag und Dienstag in Skopje und Pristina getroffen hat. Und fast scheint es so, als wolle Hahn, der bis heute mit dem ehemaligen Wissenschaftsminister, ÖVP-Wien-Chef und Balkan-Kenner Erhard Busek vertrauliche Gespräche führt, in die Fußstapfen seines politischen Ziehvaters treten. Ein Indiz dafür sei,

sagen Vertraute: „Hahn hört auf seine Experten im Ministerium und vertraut ihren Analysen. Das war bei Busek nicht anders.“

Aber anders als Busek ist Hahn kein intimer Kenner des Balkans und war bei den Briefings vor Ort ganz offensichtlich selbst erstaunt über jene Zustände, mit

denen Studierende und Wissenschaftler vor allem im Kosovo konfrontiert sind.

Neben der einzigen staatlichen Universität im Kosovo, die vom Ministerium in Pristina verwaltet wird, sind in den letzten Monaten 24 Privatuniversitäten vom zuständigen Minister genehmigt worden. Einige dieser Privat-Unis werden von Tankstellenbesitzern oder Hoteliers geführt. Dass Bedarf an Bildung herrscht, belegen die Zahlen: Die Uni Pristina nimmt pro Jahr 7.000 Studierende auf, hat aber gleichzeitig 20.000 Bewerbungen. Seit vier Monaten versucht nun Professor Johann Günther, ehemaliger Vizerektor der Uni Krems, mit den zuständigen Stellen eine Akkreditierungsbehörde mit ausländischen Experten für die Universitäten einzurichten. Ein Schritt, der zwischen Österreichern und der Kosovo-Regierung vereinbart wurde. Hahns Besuch sollte nun Druck auf die Regierung machen sowie den Austausch von Lehrenden und Studierenden fördern. Weil, so Hahn: „Unser Ziel muss lauten: Bis 2020 soll jeder Student in Europa ein Jahr im Ausland studiert haben.“ Wieder so ein Satz.

- M. Pühringer/Skopje/Pristina

**1/2**

**quer**

**210x140mm**

**abfallend !**